

## **Raporti i vlerësimit të cilësisë nga studentët për vitin akademik 2022/2023 Programi: Dizajn Grafik dhe Multimedia**

### **1. Hyrja**

Në këtë raport janë paraqitur vlerësimet e programit, mësimeve dhe lëndëve nga studentët e programit Dizajn Grafik dhe Multimedia.

Vlerësimi i programit është realizuar përmes pyetësorit për vlerësim të programit të vendosur në Sistemin e Menaxhimit Universitar (SMU), i cili përmban 21 komponentë. Ky vlerësim realizohet një herë brenda një viti akademik dhe vlerësimi bëhet nga të gjithë studentët e këtij programi. Pyetjet e vlerësimit të programit janë kryesisht të përpiluara në formë të pohimeve dhe vlerësimi i tyre është bërë sipas shkallës së likertit (1 - Nuk pajtohem fare; 2 - Nuk pajtohem; 3 - Neutral; 4 - Pajtohem; dhe 5 - Pajtohem plotësisht).

Vlerësimi i lëndëve dhe mësimeve gjithashtu janë realizuar përmes pyetësorit të vendosur në Sistemin e Menaxhimit Universitar (SMU). Për dallim nga vlerësimi i programit, i cili realizohet një herë brenda një viti akademik, vlerësimi i lëndës dhe mësimeve realizohet në fund të çdo semestri. Edhe te ky vlerësim pyetjet janë të ndërtuara në formë të pohimeve dhe vlerësimi i tyre është bërë sipas shkallës së likertit (1 - Nuk pajtohem fare; 2 - Nuk pajtohem; 3 - Neutral; 4 - Pajtohem; dhe 5 - Pajtohem plotësisht).

### **1.1 Raporti i vlerësimit të Programit nga studentët për vitin akademik 2022/2023**

Bazuar në rezultatet e vlerësimit të programit të paraqitura në tabelën nr. 1, vërejmë se më shumë se gjysma e komponentëve të këtij sesi janë vlerësuar me 4.00 e më lartë nga studentët. Duke iu referuar këtyre rezultateve, rëndësi e veçantë duhet t'iu kushtohet komponentëve të cilët janë vlerësuar me më pak se 4.00. Në përgjithësi, kënaqshmëria e

studentëve me programin këtë vit akademik është 80% apo 3.99. Kur e krahasojmë këtë rezultat me atë të vitit paraprak, vërejmë se kemi një rënie të kënaqshmërisë së studentëve me programin për rreth 1.5%.

Pohimi	Viti paraprak	Viti aktual
Materialet e prezentuara gjatë ligjëratave na jepen rregullisht	<b>4.03</b>	<b>3.90</b>
Literatura e sygjëruar për lëndët na bëhet e ditur që në fillim të semestrit	<b>4.05</b>	<b>4.04</b>
Syllabuset e lëndëve u ofrohen me kohë studentëve	<b>4.02</b>	<b>4.06</b>
Studentët janë të njoftuar me orarin e konsultimeve të mësimdhënësve	<b>4.05</b>	<b>4.02</b>
Orari i konsultimeve me mësimdhënësit respektohet	<b>4.00</b>	<b>3.90</b>
Që në fillim të vitit studentët janë të njoftuar me mënyrën e vlerësimit për lëndën përkatëse	<b>4.13</b>	<b>4.04</b>
Metodat e mësimdhënies ofrojnë mënyrën më të mirë të arritjes së rezultateve të mësimnxënies	<b>4.03</b>	<b>4.02</b>
Mësimi online (përmes Microsoft Teams) nuk dallon shumë nga ai në klasë	<b>3.83</b>	<b>3.77</b>
Sistemi i Menaxhimit Universitar (SMU) është i lehtë për përdorim dhe i plotëson nevojat e studentëve	<b>3.96</b>	<b>4.05</b>
Sallat e mësimi janë të pajisura mirë me mjete audio-vizuale për konkretizimin e mësimi	<b>4.11</b>	<b>3.95</b>
Ekziston një lidhje e mirë e mësimi teorik dhe atij praktik	<b>4.06</b>	<b>4.01</b>
Studentit është i lirë që vetë të përcaktohet për lëndët zgjedhore	<b>4.07</b>	<b>4.05</b>
Orari i mësimi shpallet me kohë	<b>4.06</b>	<b>4.05</b>
Orari i shpallur i mësimi respektohet nga mësimdhënësit	<b>4.05</b>	<b>4.02</b>
Programi i studimit është në përputhje me nevojat e tregut të punës	<b>4.08</b>	<b>4.00</b>
Programi i studimit është i krahasueshëm me programet e ngjashme në Universitete të tjera	<b>4.11</b>	<b>4.02</b>
Angazhimi i studentit në lëndë është i balancuar (nuk është i mbingarkuar)	<b>4.06</b>	<b>3.90</b>
Puna praktike jashtë institucionit organizohet mirë nga Universiteti	<b>3.94</b>	<b>3.89</b>
Mundësitë e punësimit pas përfundimit të studimeve janë të njohura për studentët	<b>4.08</b>	<b>3.89</b>

Mendimi im i përgjithshëm për këtë program te studimit është pozitiv	<b>4.14</b>	<b>4.06</b>
Këtë program të studimit do t'ia sugjeroja edhe të tjerëve	<b>4.12</b>	<b>4.10</b>

Tabela nr. 1 Vlerësimi i programit

## **1.2 Raporti kumulativ i vlerësimit të lëndëve dhe mësimdhënësve për programin Dizajn Grafik dhe Multimedia për vitin akademik 2022/2023**

Mësimdhënësit e programit Dizajn Grafik dhe Multimedia janë vlerësuar në çdo semestër nga studentët dhe në tabelën nr. 2 janë paraqitur rezultatet kumulative të këtij vlerësimi për secilin komponent. Bazuar në rezultatet e vlerësimit të stafit akademik, vërejmë se të gjithë komponentët e këtij sesioni janë vlerësuar pozitivisht nga studentët, ose më saktësisht me mbi 4.00, përpos njërit prej tyre që është vlerësuar me 3.98. Në përgjithësi, kënaqshmëria e studentëve me mësimdhënësit e tyre për vitin 2022/2023 është 85% apo 4.28.

Pohimi	Mesatarja
Mësimdhënësi organizon dhe prezanton mirë materialin e lëndës	<b>4.38</b>
Mësimdhënësi përdor shembuj të mjaftueshëm praktik në klasë (raste studimore, punë praktike në laborator)	<b>4.24</b>
Mësimdhënësi i ka kushtuar kohë të mjaftueshme sqarimit të koncepteve komplekse	<b>4.25</b>
Mësimdhënësi jep udhëzime të qarta dhe të mjaftueshme për të kuptuar ushtrimet dhe detyrat e lëndës	<b>4.37</b>
Njohuritë dhe përvojat praktike të mësimdhënësit në industri kanë qenë të dobishme për mua	<b>4.38</b>
Gjatë orëve të ligjëratave mësimdhënësi u ka dhënë mundësi studentëve të bashkëveprojnë mes tyre	<b>4.21</b>
Mësimdhënësi ka nxitur pjesëmarrjen aktive dhe debatin mes studentëve	<b>3.98</b>
Mësimdhënësi ka qenë i çashtë për sqarime dhe ndihmë shtesë me lëndën	<b>4.34</b>
Mësimdhënësi më ka dhënë informata kthyesë të dobishme dhe konstruktive për detyrat/angazhimet tjera	<b>4.33</b>
Mësimdhënësi ka dhënë udhëzime të dobishme për zhvillimin tim në lëndën	<b>4.29</b>
Mësimdhënësi ka nxitur interesimin tim për lëndën dhe fushën në përgjithësi	<b>4.28</b>

Mësimdhënësi ka përdorur mirë teknologjinë gjatë procesit mësimor (teams, forms, programe softuerike etj...)	<b>4.25</b>
--	-------------

Tabela nr.2 Vlerësimi i mësimdhënësve

Në tablën nr. 3 janë shfaqur rezultatet e vlerësimit të lëndëve në programin Dizajn Grafik dhe Multimedia nga studentët e këtij programi. Të gjithë komponentët e këtij sesioni janë vlerësuar me mbi 4.00, dhe kënaqshmëria e studentëve me lëndët e programit për vitin akademik 2022/2023 është 87% apo 4.34.

Pohimi	Mesatarja
Lënda është e përshtatshme për programin e studimit	<b>4.42</b>
Qëllimi dhe objektivat e lëndës janë të sqaruar mire	<b>4.32</b>
Literaturat dhe materialet shtesë të lëndës (librat, shembujt praktik, burimet shtesë për lexim) ishin të përditësuara, të çasshme, dhe të përshtatshme	<b>4.30</b>
Lënda është realizuar në mënyrë efektive (bazuar në syllabusin e lëndës)	<b>4.33</b>
E kam pasur të qartë se çfarë pritet prej meje sa i përket angazhimeve të mia në këtë lëndë	<b>4.53</b>
Mjetet dhe materialet e përdorura gjatë mësimimit më kanë ndihmuar të kuptoj lëndën më mirë	<b>4.40</b>
Aktivitetet në klasë më kanë ndihmuar të kuptoj lëndën më mirë	<b>4.38</b>
Lënda ka pasur një balancë të mirë të ligjëratave teorike dhe mësimimit praktikës (ushtrimeve numerike, rasteve të studimit, vizita studimore etj..)	<b>4.24</b>
Kam pasur informata të detajuara për mënyrën e vlerësimit	<b>4.41</b>
Puna në grupe më ka ndihmuar të zhvilloj shkathhtësitë e bashkëpunimit	<b>4.15</b>
Mësimimi praktik (puna në laborator, puna në terren, përdorimi i shembujve praktik etj....) më ka ndihmuar të zhvilloj kompetencat profesionale	<b>4.25</b>

Tabela 3. Vlerësimi i lëndëve